



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1228 Prot.

Tiranë, më 14.09 2026

VENDIM QARKULLUES

Nr. 121 Datë 14.09 2026

PËR
MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PÛRKOHSHME
STAF AKADEMIK PËR TRE NJËSITË KRYESORE TË UNIVERSITETIT TË
SPORTEVE TË TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027

Në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma (ç), të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", në VKM me nr.123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës" në VKM me nr. 243, datë 20.04.2023 "Për një ndryshim në VKM nr. 748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë", në VKM me nr. 329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", në Udhëzimin e MASR me nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet publike të Arsimit të Lartë", në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes me nr. 1631/1 prot., datë 09.09.2026 "Kërkesë për personel akademik të jashtëm për vitin akademik 2026-2027 në FSHL", në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit me nr. 1631/2 prot., datë 10.09.2026 "Planifikimi për personel akademik me kohë të pjesshme pranë FVFR, për vitin akademik 2026-2027", në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit me nr. 1631/3 prot., datë 10.09.2026 "Planifikimi për personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2026-2027", pranë FSHR-së", Senati Akademik në mbledhjen e radhës,

V E N D O S I:

Miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik për tre njësitë kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranë, për vitin akademik 2026-2027, si më poshtë:

- | | |
|--|------------|
| 1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik FSHL | 13 persona |
| 2. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik FVFR | 10 persona |
| 3. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik FSHR | 18 persona |

4. Efektet financiare mbulohen nga grandit e ardhur nga MAS dhe të ardhurat e Universitetit.
5. Ky vendim t'i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të UST.

KRYETARI I SENATIT
PROF. DR. AGRON KASA

